

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1038 Prot.

Tiranë, më 22.08 2017

VENDIM Nr. 161, datë 26.07.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.10, datë 26.07.2017, pasi shqyrtoi Konceptin dhe metodologjinë e kryerjes së gërmimit arkeologjik në zonën e përcaktuar si zonë me potencial arkeologjik Chance Find, Korçë - Dersnik KM 46+595- KM 46+935, "*Linja e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)*" -subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k..

VENDOSI:

1. Të miratojë Konceptin dhe metodologjinë e kryerjes së gërmimit arkeologjik në zonën e përcaktuar si zonë me potencial arkeologjik Chance Find, Korçë - Dersnik KM 46+595- KM 46+935, "*Linja e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)*" -subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Shoqëria "SPIECAPAG Shqipëria" duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila do të kryejë gërmimin arkeologjik të shpëtimit si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri. Raporti i gërmimit arkeologjik të shpëtimit të paraqitet në KKA e radhës.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrisë Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KURTI

MINISTRE



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO